



Faik Hoti

Kryeredaktor i Revistës Mjeku

Ky numër i revistës “Mjeku” i është kushtuar në tërësi shëndetit publik, në nderim të 100 vjetorit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. Jo thjesht, sa për të rikujtuar se shërbimet e mjekësisë preventive kanë qenë të parat që janë themeluar në Kosovë dhe datojnë që nga vitet 1923-1925, por për të ritheksuar, përtej një përvjetori simbolik dhe reflektimi mbi historinë e tij, vëmendjen rreth së ardhmes së shëndetit publik në Kosovë.

Shëndetësia publike në Kosovë e ka dëshmuar veten si një front i parë i mbrojtjes në luftën kundër sëmundjeve infektive dhe, në masë të konsiderueshme edhe ndaj atyre kronike jo-ngjitëse. Me gjithë resurset e kufizuara ndër vite, Kosova ka çrrënjësuar sëmundje të rënda ngjitëse, ka vendosur nën kontroll sëmundje të tjera dhe ka ndërtuar e zbaton një Program të Zgjeruar të Imunizimit që bazuar në rezultate, rreshtohet ndër më të mirët në Evropë.

Gjatë pandemisë COVID-19, ishte infrastruktura e shëndetit publik që mbajti barrën kryesore të përgjigjes, nga përgatitja e planeve të reagimit, mbikëqyrja epidemiologjike, gjurmimi e testimi laboratorik i rasteve, komunikimi i rrezikut e deri tek vaksinimi masiv. Investimet në kapacitetet laboratorike, ngritja e sistemeve të mbikëqyrjes epidemiologjike, investimet në Zinxhirin e ftohtë të ruajtjes së vaksinave dhe forcimi i partneriteteve ndërkombëtare me OBSH-në, UNICEF-in e ECDC-në, janë hapa të rëndësishëm.

Këto arritje nuk do të ishin të mundshme pa përkushtimin e një brezi profesionistësh që u formuan në rrethana të vështira, por që ndërtuan themelet e sistemit, me përvojë, etikë dhe përgjegjësi profesionale, duke ndërvepruar me brezat më të ri. Por, shumë prej këtij brezi që barti barrën e zhvillimit të shëndetësisë publike kanë dalë ose po i afrohen pensionimit, derisa të tjerët me përvojë gjithashtu, kanë braktisur shërbimin aktiv në sistemin publik. Brezi i ri ndërkaf, po hyn në skenë, me përgatitje profesionale që lë vend për diskutim përballë sfidave reale dhe emergjencave të shëndetit publik.

Një lloj çekuilibri i krijuar qartazi në satisfaksionin që marrin për punën e tyre ekspertët e disa prej fushave të shëndetit publik në raport me ekspertët e fushave klinike, ka ndikuar që shëndetësia publike të mos jetë për gjeneratat e reja çdo herë një zgjedhje e motivuar nga pasioni, vizioni, përkushtimi apo dashuria për shëndetësinë publike, por më tepër e reduktuar në një opsion të dytë nga mungesa e alternativave. Ky është një fakt i prekshëm. Kualiteti i studimeve dhe aftësisë specifik, gjithashtu, duhet të trajtohen me një sy më kritik. Për këtë arsye, duhet rritur motivimin dhe kapacitetin njerëzor për këtë fushë, sepse një sistem shëndetësor nuk fillon në spital, por në komunitet, me edukimin shëndetësor, parandalimin, diagnostikimin e hershëm dhe ndërhyrjet në kohë. Pa shëndet publik të fortë, asnjë shërbim klinik apo spitalor nuk është efektiv dhe as i qëndrueshëm. Në shekullin e dytë të IKSHPK-së që sapo ka nisur, nevojitet një mbështetje e qëndrueshme politike dhe financiare për shëndetësinë publike. Kjo nuk është vetëm çështje profesionale, është çështje e sigurisë kombëtare, drejtësisë sociale e profesionale dhe përgatitje për të ardhmen, sepse shëndetësia publike përfaqëson mbrojtjen e jetës dhe parandalimin e sëmundjes për të gjithë, pa dallim. Nëse nuk kuptohet kështu, rrezikohet që shëndeti publik të mbetet një segment që reagon, por nuk udhëheq. E në një kohë kur rreziqet globale janë gjithnjë e më të shprehura dhe më të lidhura, një sistem shëndetësor pa një shëndetësi publike të mirë organizuar është një sistem i ekspozuar ndaj rreziqeve dhe i pambrojtur.

Për këtë arsye, 100-vjetori i IKSHPK-së nuk është vetëm një datë historike. Është një thirrje e qartë për një kontratë të re shoqërore: ku shëndeti publik nuk shihet si kosto, por si investimi më i zgjuar dhe më i drejtë parandalues që mund të bëjë një shoqëri normale dhe e përgjegjshme në raport me shëndetin e saj.